

NJIHUNI ME BASHKINË TUAJ!

MANUAL INFORMUES



FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG





MBI 140.000 të rinjve u lind e drejta për të votuar për herë të parë në zgjedhjet vendore 2019 në Shqipëri. E drejta e votës është një e drejtë mjaft e rëndësishme, për të cilën shumë prej të rinjve nuk janë të informuar jo vetëm mbi procesin e votimit dhe rëndësinë e saj, por edhe mbi rolin e qeverisjes vendore



Përmes pjesëmarrjes në votime dhe më pas në qeverisje, publiku ndikon në krijimin e një qeverisjeje që është në funksion të qytetarit dhe interesave të tij.

Misioni i Qëndresës Qytetare është të fuqizojë rolin e qytetarit në shoqëri në funksion të përmirësimit të qeverisjes, forcimit të strukturave komunitare dhe promovimit të aktivizmit në Shqipëri.

Edukimi dhe kultivimi i një brezi të ri aktiv për tu angazhuar në jetën publike është një sfidë sidomos e demokracive të reja të cilat vuajnë apatinë si dhe mungesën e traditës së pjesëmarrjes në vendimmarrje, prandaj ky manual do të pasqyrojë në mënyrë të përmbledhur një informacion të përgjithshëm mbi rolin, kompetencat dhe funksionet e Bashkive dhe organeve të tyre drejtuese, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

ORGANIZMI I QEVERISJES VENDORE

12 QARQE

Përbëbëhen nga disa bashki.

Janë unitete administrativo-territoriale të përbëra nga disa bashki me lidhje gjeografike, tradicionale dhe ekonomike

61 BASHKI

Përbëbëhen nga disa njësi administrative.

Janë unitete administrativo-territoriale, të përbëra nga disa njësi administrative me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike

381 NJËSI ADMINISTRATIVE

Janë unitete administrativo – territoriale të përbëra nga qytete ose fshatra.

70 QYTETE

Janë unitete administrativo-territoriale të përbëra nga disa lagje.

FSHATI

LAGJIA

Krijohet me Vendim të Këshillit Bashkiak, në territore me mbi 20.000 banorë

ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Kryetari i Bashkisë

Këshilli Bashkiak

Administratori i njësisë vendore

Strukturat komunitare në bashki

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Kryesia e Këshillit të Qarkut

Këshilli i Qarkut

CFARË BËN BASHKIA NË SHËRBIM TË QYTETARËVE?

Për Infrastrukturrën dhe Arsimin

- Furnizon territorin e saj me ujë të pijshëm
- Trajton ujërat e ndotura
- Siguron mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara
- Ndërton dhe mirëmban rrugët vendore dhe sinjalizimin rrugor
- Siguron ndriçimin e mjediseve publike
- Garanton transportin publik vendor
- Ndërton dhe mirëmban varrezate publike
- Garanton shërbimin publik të varrimit
- Garanton shërbimin e dekorit publik.
- Ndërton parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike
- Siguron mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake
- Ndërton dhe mirëmban ndërtesat arsimore të sistemit shkollor parauniversitar
- Administron sistemin arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe

Për Infrastrukturon dhe Arsimin

- Ndërton dhe mirëmban qendrat e shërbimit shëndetësor parësor
- Administron qendrat e shërbimeve në fushën e shëndetit publik.
- Siguron planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit
- Garanton regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë
- Pajis institucionet arsimore me mjete mësimore
- Mbështetet nxënësit e familjeve në nevojë dhe atyre me arritje të shkëlqyera
- Administron godinat e trajtimit të studentëve (Konviktet)

Për Shërbimet Social-Kulturore

- Krijon dhe administron shërbimet sociale në nivel vendor
- Ndërton dhe administron banesat për strehimin social
- Ndërton dhe administron qendrat për ofrimin e shërbimeve sociale vendore
- Mbron dhe promovon vlerat e trashëgimisë kulturore me interes vendor
- Organizon aktivitetet kulturore dhe promovon identitetin kombëtar e lokal
- Zhvillon dhe promovon bibliotekat e ambientet për lexim
- Organizon aktivitete sportive, çlodhëse dhe argëtuese

Mjedisin dhe Pyjet

- Merr masa për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe ndotjes nga zhurmat
- Përgatit planet e veprimit vendor për mjedisin
- Zbaton planet vendore të veprimit për zhurmën si dhe shpall zonat e qeta
- Merr masa parandaluese për respektimin e vlerës kufi të zhurmës
- Siguron përmirësimin e gërryerjeve, rrëshqitjeve e të ortekëve brenda territorit të bashkisë
- Mbikqyr zhvillimin e florës dhe faunës së egër
- Mirëmban dhe adminsitron fondin pyjor bashkiak

Sigurinë Publike dhe Mbrojtjen nga Zjarri

- Merr masa për ruajtjen e pasurisë së bashkisë
- Prish ndërtime dhe zëniet e paligjshme të objekteve publike të bashkisë
- Siguron qetësinë publike
- Merr masa për ruajtjen e rendit kur ka grumbullime njerëzish, si në tregje, panairë etj
- Inspekton zbatimin e legjislacionit për veprimtarinë e shitblerjes në mjedise publike
- Merr masa sigurie për të parandaluar fatkeqësitë natyrore, si dhe ndihmon në kapërcimin e tyre
- Ngre stacionet e shërbimit zjarrfikës
- Siguron infrastrukturën dhe personelin për shërbimin e mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri
- Merr masa organizative e teknike dhe planifikon fonde financiare për mbrojtjen nga zjarri
- Merr masa për inspektimin, parandalimin dhe ndërhyrjen për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin në territorin e bashkisë
- Krijon shërbimin vullnetar për mbrojtjen nga zjarri

Bujqësinë dhe Zhvillimin Ekonomik Vendor

- Siguron infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin bujqësor dhe rural
- Krijon programin për bujqësinë dhe zhvillimin rural në nivel vendor
- Harton plane strategjike për zhvillimin ekonomik vendor
- Administron tregjet publike
- Mbështetet zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse
- Publikon broshura informative dhe krijon portale me profil ekonomik.
- Jep grante financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm duke garantuar akses të balancuar gjinor.
- Ndërton, mirëmban dhe krijon hartën dixhitale të rrugëve rurale (të fshatit)
- Mban inventarin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja
- Mbikqyr sigurinë e digave të rezervuarëve për ujitje
- Monitoron sasinë dhe cilësinë e ujit që përdoret gjatë një viti
- Cakton dhe mbledh tarifën vjetore të mirëmbajtjes dhe shërbimit të ujitjes për çdo sipërfaqe toke



ÇFARË PUNE BËN KRYETARI I BASHKISË?

Kryetari i Bashkisë

- **Është organi ekzekutiv i Bashkisë**
- Ushtron vendimmarrjen e tij nëpërmjet urdhrave, urdhëresave dhe vendimeve të kryetarit
- Mund të **zgjidhet dhe të ushtrojë vetëm 3 mandate** të njëpasnjëshme në krye të bashkisë
- Ndihmohet nga një ose më shumë zëvendëskryetarë dhe nga personeli i administratës.



Mandati normal i Kryetarit të Bashkisë zgjat 4 vjet
Kryetarit të Bashkisë i mbaron mandati përpara afatit në rastet kur:

- Nuk pranon të bëjë betimin
 - Jep dorëheqjen
- Nuk është më banor i përhershëm i bashkisë ku është zgjedhur
- Shkarkohet kur kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve
- Dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim të formës së prerë nga gjykata
- Propozohet për shkarkim nga Këshilli Bashkiak përkatës për mosparaqitje në detyrë për një periudhë 3-mujore të pandërprerë
 - Kandidon për deputet
- Humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate të formës së prerë
 - Humb jetën

DETYRAT E KRYETARIT TË BASHKISË

- ✓ Ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë
- ✓ Raporton në këshill për gjendjen ekonomiko-financiare të bashkisë dhe njësisve administrative përbërëse të paktën çdo 6 muaj ose sa herë kërkohet nga këshilli
- ✓ Është anëtar i Këshillit të Qarkut
- ✓ Emëron ose shkarkon zëvendëskryetarët e bashkisë, administratorët e njësisve administrative
- ✓ Emëron ose shkarkon anëtarët e organeve drejtuese të shoqërive tregtare në pronësi të bashkisë
- ✓ Ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë, si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët
- ✓ Merr masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive
- ✓ Kthen për rishqyrtim jo më shumë se një herë në këshill vendime, kur vëren se ato çenojnë interesa të bashkësisë.
- ✓ Miraton strukturën, organikën dhe kategoritë e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë
- ✓ Kujdeset për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore, të ndara sipas gjinisë, dhe siguron publikimin e tyre.





ÇFARË BËN KËSHILLI BASHKIAK?

Këshilli Bashkiak

- **është organi përfaqësues i Bashkisë**
- funksionon në bazë të rregullores së miratuar nga vetë këshilltarët
- ushtron vendimmarrjen e tij nëpërmjet urdhrave, urdhëresave dhe vendimeve
- përbëhet nga: Kryetari; Zv/kryetarët; Sekretari; Këshilltarët



Mbledhja e Këshillit

Thërritet

- me kërkesën e Kryetarit të Bashkisë
- me shkrim të jo më pak se 1/3 së anëtarëve të tij
- e motivuar nga prefekti për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij

Realizohet

- kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit
- e hapur ose e mbyllur për publikun.

Mbledhja e mbyllur realizohet me kërkesën e Kryetarit të Bashkisë ose të 1/5 së anëtarëve të Këshillit Bashkiak, kur për këtë kanë votuar jo më pak se tre të pestat e gjithë anëtarëve të tij.

KËSHILLI BASHKIAK

- ✓ Miraton buxhetin e bashkisë dhe ndryshimet e tij
- ✓ Përcakton numrin maksimal të punonjësve, taksat dhe tarifat vendore
- ✓ Zgjedh komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet
- ✓ Zgjedh dhe shkarkon duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin, zëvendëskryetarët, sekretarin e këshillit dhe përfaqësuesit e këshillit.
- ✓ Vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve
- ✓ Vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore
- ✓ Miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve
- ✓ Miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar
- ✓ Vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet
- ✓ Vendos për simbolet e bashkisë, emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë
- ✓ Jep tituj nderi dhe stimuj

VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK


- ✓ Publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë
- ✓ Shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
- ✓ Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to



SI MUND TË BËHENI PJESË E VENDIMMARRJES NË BASHKINË TUAJ?

E drejta e votës

E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur është e garantuar nga Kushtetuta e Shqipërisë. Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.



Vota nuk është vetëm e drejtë apo privilegj, por edhe përgjegjësi qytetare pasi nëpërmjet saj ju i delegoni të drejtën për tu qeverisur 4 vjet Kryetarit të Bashkisië dhe anëtarëve të Këshillit Bashkiak.



Nëpërmjet votimit ju bëheni në mënyrë të drejtpërdrejtë pjesë e vendimmarrjes pasi ju lind edhe e drejta qytetare për ti kërkuar llogari gjatë katër viteve të zgjedhurve tuaj.



Vota është vetjake. KQZ detyron organet kompetente të bëjnë regjistrimin e saktë të zgjedhësve në lista, të pajisin me fletë votimi çdo votues, të sigurojnë dhomën e fshehtë, si dhe të garantojnë çdo votues të hyjë i vetëm në këtë dhomë për të vendosur për votën e tij.



Nga kjo e drejtë përjashtohen vetëm shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë, si të paafte mendërisht. Kurse, të dënuarit që janë duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë, kanë vetëm të drejtën për të zgjedhur.



E DREJTA E INFORMIMIT



E drejta për informim është e drejta e çdo qytetari për t'u njohur me informacionin publik e garantuar ekskluzivisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji Nr. 119/2014 për të drejtën e informimit i cili synon nxitjen e integritetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Për të pasur një qeverisje lokale të mirë dhe demokratike, transparencja përbën një nga elementët thelbësorë që duhet të garantojnë për të gjithë qytetarët. Ajo nënkupton ndarjen e informacionit si edhe ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve në mënyrë të hapur me publikun.

Aksesi i lirë ndaj informacionit luan një rol kyç në parandalimin e korrupsionit, dhe si i tillë institucionet shtetërore duhet ta ofrojnë atë në kohë dhe në mënyrë të plotë për qytetarët.

Bashkitë, sipas kuadri ligjor, janë të detyruara të caktojnë një person përgjegjës për të drejtën e informimit i cili titullohet Koordinatori për të Drejtën e Informimit



KONSULTIMI PUBLIK

Konsultimi publik është përfshirja e mendimit qytetar në vendimmarrjen e bashkisë dhe Këshillit Bashkiak. Çdo qytetar ka të drejtën e njohjes dhe pjesëmarrjes në procesin e konsultimit publik

Përfitimet e konsultimit publik:

- Procesi i bashkëpunimit midis bashkisë dhe qytetarëve lokalë prodhon qeverisje demokratike
- Vendime më të mira – qytetarët janë një burim me vlerë i zgjuarsisë rreth situatës në bashkinë e tyre.
- Fuqizimi i marrëdhënies së qytetarëve me Bashkinë nëpërmjet mjeteve të hapura dhe efektive të komunikimit midis drejtuesve të bashkise dhe qytetarëve lokalë.
- Duke përfshirë qytetarët vendore ne çështje të vendimmarrjes lokale mundësohet gjithashtu aftësimi i kapaciteteve të tyre dhe rritet besimi për të ndërmarrë sfida të tjera individualisht dhe kolektivisht.

Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë duhet të sigurojnë njoftimin mbi konsultimin publik në një nga format e mëposhtme:

- publikimin në regjistrin elektronik të projekt-aktit të njoftimit për konsultim
- publikimin në programin e transparencës
- dhënien e informacionit në të gjitha fazat e konsultimit publik
- organizimin e takimeve konsultative dhe takime publike me palët e interesuara

Bashkitë sipas kuadrit ligjor, janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes dhe të caktojnë **koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik.**

E DREJTA E KËRKESËS, ANKESËS DHE VËREJTJES



Sipas nenit 19 të ligjit për vetqeverisjen vendore çdo qytetar apo grupe qytetarësh që përfaqësojnë komunitetet lokale kanë të drejtë t'u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje bashkisë ose Këshillit Bashkiak për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca të juridiksionit të bashkisë.

E DREJTA E PETICIONIT



Peticioni është një mekanizëm i rëndësishëm i demokracisë pjesëmarrëse pasi inicohet nga publiku, në dallim me informimin dhe konsultimin publik që janë detyra të bashkisë.

E drejta e peticionit është e parashikuar në kapitullin e lirive politike në nenin 48 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet se kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t'u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.

Çdo person apo organizatë me interes në një bashki të caktuar ka të drejtën e hartimit dhe nënshkrimit të peticionit drejtuar Këshillit Bashkiak për çdo çështje që lidhet me përgjegjësitë dhe kompetencat e bashkisë. Pas pranimit të peticionit, Këshilli Bashkiak shqyrton atë duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në rregulloren e tij të punës.

INICIATIVA QYTETARE

Iniciativat qytetare për të propozuar dhe hartuar politika janë një mekanizëm tjetër që fuqizon komunitetin për të vepruar dhe për të ndryshuar politikat në bashkitë e tyre.

Sipas nenit 20 të ligjit për vetëqeverisjes vendore, çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se 1% të banorëve të bashkisë kanë të drejtë të paraqesin për vendimmarrje në Këshillin Bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre iniciativave, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak.

Propozimet e ardhura në Këshillin Bashkiak si iniciativë qytetare, kur kanë ndikim financiar në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, shqyrtohen në këshill, sipas rendit të ditës, dhe nuk mund të miratohen pa marrë më parë mendimin e Kryetarit të Bashkisë.



6 hapat e paraqitjes së iniciativës qytetare sipas rregulores së Këshillit Bashkiak Shkodër të miratuar më 02/11/2016:

1. Propozimet duhet të jenë në formë të shkruar dhe të përmbajnë: a)propozuesin/it; b)objektin që propozohet; c)bazën ligjore të propozimit; ç)arsyet e propozimit dhe efektet e pritshme të aktit; d)materiale shtesë nëse ka.
2. Propozimi shoqërohet me listën e personave propozues, nënshkrimin e tyre, nr: personal, të dhënat dhe adresën e përfaqësuesit.
3. Propozimi dorëzohet zyrtarisht, në zyrën e protokoll arkivit të bashkisë.
4. Këto propozime para se ti paraqiten këshillit duhet të marrin konfirmimin për bazueshmërinë ligjore, nga drejtoria/sektori juridik i bashkisë.
5. Sekretari i këshillit përcjell pranë sektorit juridik propozimin dhe ky sektor duhet të shprehet për bazueshmërinë ligjore të propozimit jo më vonë se 10 ditë nga marrja e kërkeses.
6. Kur këto propozime kanë ndikim financiar në buxhetin e bashkisë duhet të marrin paraprakisht edhe mendimin me shkrim të kryetarit të bashkisë.

MBLEDHJET E KËSHILLIT BASHKIAK



Çdo qytetari i lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara nga këshilli dhe në media. Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

Mbledhja e Këshillit:

- Thërritet me kërkesën e Kryetarit të Bashkisë; me shkrim të jo më pak se $1/3$ së anëtarëve të tij; e motivuar nga prefekti për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.
- Quhet e vlefshme kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë tjetër për marrjen e vendimeve.
- Me kërkesën e Kryetarit të Bashkisë ose të një të pestës së anëtarëve të këshillit bashkiak, mbledhjet e këshillit bashkiak mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar jo më pak se tre të pestat e gjithë anëtarëve të tij.

REFERENDUMET VENDORE



Referendumet vendore janë një nga format e shprehjes së demokracisë së drejtëpërdrejtë në qeverisjen vendore ku nëpërmjet pjesëmarrjes së qytetarëve vendoset për çështje me rëndësi për komunitetin. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë thuhet shprehimisht se vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore.

Gjithashtu në Kodin Zgjedhor, me termin referendum kuptohet **ushtrimi i drejtëpërdrejtë i sovranitetit të popullit**, nëpërmjet votimit, për një çështje ose një ligj të caktuar.

Kushtet për zhvillimin e referendumit vendor:

Referendumet vendore nuk mund të zhvillohen gjatë periudhës nga tre muaj para përfundimit të mandatit të organeve të qeverisjes vendore, deri tre muaj pas mbledhjes së parë të këshillave vendorë. Në rastet kur në një njësi të qeverisjes vendore shpallen zgjedhje të parakohshme, Kodi Zgjedhor kërkon që procedura për zhvillimin e referendumit vendor në atë njësi të pezullohet deri pasi të kenë kaluar tre muaj nga fillimi i mandatit të organit të qeverisjes vendore.

Një tjetër kusht për kërkesat për referendum është edhe fakti që ato kërkesa që nuk arrijnë të kalojnë nëpër të gjitha procedurat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor, brenda datës 15 mars të çdo viti, pavarësisht se kur ato paraqiten, shtyhen deri në vitin pasardhës.

Administrimi i referendunit vendor:

Për administrimin e referendumeve vendore, Kodi Zgjedhor ngarkon Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, organ i cili e realizon këtë detyrë nëpërmjet KZQV-ve. KQZ administron referendumin vendor në përputhje me procedurat e parashikuara për zhvillimin e zgjedhjeve vendore, duke theksuar se, për çdo rast, kjo detyrë duhet të kryhet për aq sa është e mundur ose e nevojshme.

Nisma për referendum vendor:

Në Kodin Zgjedhor është trajtuar edhe çështja që lidhet me nismën për një referendum vendor. Sipas këtij Kodi Zgjedhor (neni 132), nismën për një referendum vendor, për një çështje të qeverisjes vendore, mund ta ushtrojnë:

-10 % e zgjedhësve të regjistruar në listat e zgjedhësve të njësisë vendore përkatese ose 20 mijë prej tyre, cilado shifër më e vogël.

-Një numër Këshillash Bashkiakë, që përfaqësojnë jo më pak se një të tretën e popullsisë së një qarku, kanë të drejtë të kërkojnë zhvillimin e një referendumi për një çështje të qeverisjes vendore në nivel qarku.

Referendumi vendor mund të mbahet për një çështje të qeverisjes vendore që njëherazi është edhe çështje e rëndësisë së veçantë.



www.qendresaqytetare.al